



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 260/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha, kryesues, Muharrem Shala dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj, paraqitur kundër Qazim Rrahmanit nga fshati Dubravë komuna e Ferizajt, në cilësinë e kryetarit të degës të subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës anti - ligjore kundër subjektit politik PDAK, në seancën e panelit të mbajtur me 17.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet poshtë ankesa si e palejuar

A R S Y E T I M I

Subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se: Qazim Rrahmani nga fshati Dubravë komuna e Ferizajt, në cilësinë e kryetarit të degës të subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) në Ferizaj, ka filluar të bëjë fushatë anti - ligjore duke dezinformuar opinionin më veprimtarin e PDAK-së, të cilën e quan me emra të ndryshëm fyes në mediat lokale të Ferizajt dhe në tubime grupore të komunitetit.

F A K T E T

Më 02 Nëntor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Subjektit politik PDAK, me pretendim se Qazim Rrahmani, në cilësinë e kryetarit të degës të subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) në Ferizaj, ka filluar fushat anti ligjore kundër subjektit politik PDAK. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD ankesës.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072

Parashtruesi i ankesës pretendon se Qazim Rrahmani në cilësinë e kryetarit të degës të subjektit politik PAI, ka shkelur Rregullën e zgjedhjeve Nr. 13/2009 për *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike* ashtu që ka filluar fushatën para certifikimit dhe para fillimit të fushatës së zgjedhjeve.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) me dispozitën e nenit 44 dhe Rregulla zgjedhore Nr.13/2009, përcakton aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Meqenëse pretendimet e parashtruara nga ankuesi nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e lart cekura ligjore andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe konstatohet se ankesa është e palejuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 260/2010 më datën 17.11.2010.

Kryesuesi-i-Panelit

